



REPubLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ARDJANA A. MEDIU
ADRESA Blv.Deshmoret e Kombit,
Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7
TEL: 692041001

AKT MARRËVESHJE

Nr. repertori: 5985

Nr. koleksioni: 2006

Tirane më 01/11/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021050620235527926

*Akti noterial përbëhet nga 5 fletë



A2021050620235527926

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. 0585 Rep.

Nr. 2006 Kol.

MARRËVESHJE
PËR PJSËTIMIN E KUOTËS

Sot, në Tiranë, më 01.11.2021, para meje Notere Ardjana A.Mediu, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tiranë, Blv."Dëshmorët e Kombit" Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 7, nënshkruhet kjo marrëveshje për pjesëtimin e kuotës ("**Marrëveshja**") së zotëruar në Shoqërinë "FINMAN" shpk, nga dhe ndërmjet palëve si më poshtë:

1. **Z.Sadik Ismailaj**, i biri i Mehmet dhe Deko, lindur më 03.02.1942, në Siqecë, Fier, banues në Fier, me numër personal identifikimi E20203169J;
2. **Z.Jonuz Ismailaj**, i biri i Sadik dhe Qazime, lindur më 05.12.1961, në Siqecë, Fier, banues në Fier, me numër personal identifikimi G11205068I;
3. **Z.Idajet Ismailaj**, i biri i Sadik dhe Qazime, lindur më 22.01.1963, në Siqecë, Fier, banues në Tiranë, me numër personal identifikimi G30122010O;
4. **Znj.Rajmonda Agalliu (Ismailaj)**, e bija e Sadik dhe Qazime, lindur më 10.08.1966, në Patos, Fier, banuese në Fier, me numër identifikimi personal G65810093W

Palët e kësaj Marrëveshje do të referohen së bashku si "Palët".


BAZA LIGJORE:

Kjo Marrëveshje është përgatitur sipas:

- Ligjit Nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, veçanërisht nenet 165, 199, 200/ç, 207;
- Ligjit Nr.9062, datë 08.05.2003 "Kodi i Familjes", i ndryshuar, veçanërisht nenet 73, 74/ç, 96/a, 97;
- Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, veçanërisht nenet 73/1 pika c), 75.

DEKLARIME PARAPRAKE:

- A. Sadik Ismailaj dhe Idajet Ismailaj në datë 24.11.2016 kanë themeluar shoqërinë FINMAN shpk ("**Shoqëria**") si një shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Regjistrin Tregtar, Qendra Kombëtare e Biznesit, me NIPT L62405030K, me kapital të regjistruar 90'000'000 Lekë (nëntëdhjetë milion lekë) ("Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë").



B. Kapitali i Shoqërisë figuron i regjistruar në pronësi të :

- z.Sadik Ismailaj – zotërues i një kuote që përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar, me vlerë nominale 45'000'000 Lekë (dyzetë e pesë milion lekë) (referuar më poshtë si "**Kuota**")
- z.Idajet Ismailaj - zotërues i një kuote që përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar, me vlerë nominale 45'000'000 Lekë (dyzetë e pesë milion lekë)

C. Në datën e themelimit të Shoqërisë (24.11.2016) ortaku themelues Sadik Ismailaj rezultoi i martuar me Znj.Qazime Ismailaj, e bija e Rustem dhe Shege, lindur më 15.07.1941, në Gjinoqar, Fier.

D. Në mungesë të një marrëveshje për përcaktimin e regjimit pasuror martesor, ndërmjet bashkëshortëve Sadik Ismailaj dhe Qazime Ismailaj, ekziston prezumimi ligjor i zbatimit të regjimit të bashkësisë ligjore, në këndvështrim të Nenit 73 të Kodit të Familjes. **Për shkak të regjimit pasuror të bashkësisë ligjore, ekziston prezumimi ligjor se, Znj.Qazime Ismailaj ka qenë bashkëpronare në ½ pjesë në Kuotën që Z.Sadik Ismailaj zotëron në Shoqëri, në këndvështrim të Nenit 74 pika "ç" e Kodit të Familjes.** Prezumimi ekziston për shkak të ligjit se **secili prej bashkëshortëve zotëronte në pjesë të pandarë 50% të Kuotës.**

E. Znj.Qazime Ismailaj ka vdekur në datë 21.08.2020. Për të ndjerën është çelur trashëgimia ligjore dhe është lëshuar Dëshmia e Trashëgimisë Ligjore me vendim të Noteres Arjana E. Dodi, Nr.1373 Rep., Nr.320 Kol., datë 26.10.2020 ("**Dëshmia e Trashëgimisë**"). Sipas Dëshmisë së Trashëgimisë, trashëgimtarë të Znj.Qazime Ismailaj janë përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë: bashkëshorti Sadik Ismailaj dhe fëmijët Jonuz Ismailaj, Idajet Ismailaj, Rajmonda Agalliu (Ismailaj).

F. Po sipas Dëshmisë së Trashëgimisë, të gjithë trashëgimtarët trashëgojnë në pjesë të barabartë dhe të pandarë ¼ e pasurisë të së ndjerës në tërësi në masën 25% të kapitalin. Në konsideratë të pjesës së trashëguar, pjesa takuese e trashëgimtarëve në kapitalin e regjistruar të shoqërisë e shprehur në përqindje si më poshtë:

- z.Sadik Ismailaj – 6.25%
- z.Idajet Ismailaj – 6.25.%
- z.Jonuz Ismailaj – 6.25%
- z.Rajmonda Agalliu (Ismailaj) – 6.25%

Duke pasur në konsideratë Deklarimet Paraprake, Palët e kësaj Marrëveshje, kanë për qëllim të pjesëtojnë Kuotën, në këndvështrim të dispozitave ligjore cituar më sipër. Për këtë qëllim, nënshkruhet kjo Marrëveshje sipas kushteve që vijojnë.

Neni 1 Objekti i Marrëveshjes

1. Objekt i kësaj Marrëveshje është pjesëtimi i Kuotës në bashkëpronësi të z.Sadik Ismailaj dhe Trashëgimtarëve të z.Qazime Ismailaj.

Fq. 2



Neni 2 Pasojat e pjesëtimit të Kuotës

- Përfundimi i bashkëpronësisë:** Si rrjedhojë e pjesëtimit të Kuotës, Palët e kësaj Marrëveshje pranojnë se përfundon bashkëpronësia mbi Kuotën dhe pushojnë automatikisht të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë për Palët për shkak të bashkëpronësisë mbi Kuotën.
- Ndryshimi i pjesëmarrjes në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë:** Për shkak të pjesëtimit të Kuotës dhe përfundimit të bashkëpronësisë, Palët pranojnë se secili do të zotërojë në mënyrë të mëvetshme nga 1 (një) kuotë në Shoqëri, e cila do të përfaqësojë pjesët e tyre takuese në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë. Kështu, me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, Kapitali i Regjistruar i Shoqërisë do të zotërohet si vijon:
 - z.Sadik Ismailaj – 31.25% të Kapitalit (përlogaritur si shumatore e 25% + 6.25% fituar me trashëgimi);
 - z.Idajet Ismailaj – 56.25% të Kapitalit (përlogaritur si shumatore e 50% + 6.25% fituar me trashëgimi);
 - z.Jonuz Ismailaj – 6.25% të Kapitalit (fituar me trashëgimi);
 - z.Rajmonda Agalliu (Ismailaj) - 6.25% të Kapitalit (fituar me trashëgimi);
- Ushtrimi i të drejtave individualisht:** Nga momenti i regjistrimit të kësaj Marrëveshje në Regjistrin Tregtar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Palët do të konsiderohen ortakë të Shoqërisë me pjesë të ndara në Kapitalin e Regjistruar të saj dhe do të ushtrjnë të drejtat e tyre mbi kuotën përkatëse, individualisht, në përputhje me Ligjin Tregtar dhe Statutin e Shoqërisë.

Neni 3 Deklarime dhe Garanci të Palëve

- Palët e kësaj Marrëveshje deklarojnë se gjatë bashkëpronësisë mbi Kuotën asnjëri prej tyre nuk ka ndërmarrë asnjë veprim që mund të çënojë pjesën takuese të palëve të tjera në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë, siç mund të jenë veprime tjetërsimi apo disponimi mbi Kuotën.
- Palët e kësaj Marrëveshje deklarojnë dhe garantojnë se gjatë bashkëpronësisë mbi Kuotën nuk ka lindur asnjë pretendim nga të tretë, subjekte shtetërore apo private, që mund të çënojë pjesën takuese të secilit bashkëpronar në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë. Në rast të një ngjarje të tillë, pala për shkak të së cilës kanë lindur pretendimet nga të tretët, detyrohet të mbajë të padëmtuar palët e tjera apo të shpërblejë ato respektivisht në rast të një dëmi të ardhur.
- Palët e kësaj Marrëveshje deklarojnë dhe pranojnë se kjo Marrëveshje në tërësinë e saj, përbën dakortësinë e tyre të plotë dhe të përvokueshme sa i përket pjesëmarrjes së tyre në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë dhe se nuk kanë asnjë pretendim në lidhje me pjesët e përcaktuara më sipër apo të drejta të tjera që burojnë nga bashkëpronësia mbi Kuotën.
- Për më tej, Palët njohin dhe pranojnë se rezultati i pjesëtimit të Kuotës buron nga trashëgimia ligjore e së ndjerës Znj.Qazime Ismailaj dhe se për këtë nga pjesëtimi i saj nuk krijohet asnjë pabarazi apo nevojë për kompensim apo shpërblim ndërmjet Palëve.



A2021050620235527926

5. Palët deklarojnë gjithashtu se nuk kanë asnjë pretendim sa i përket veprimtarisë së Shoqërisë prej datës 20.10.2021 dhe nuk kanë asnjë kompensim apo pagesë të çfarëdolloj natyre për të kërkuar në lidhje me veprimtarinë e Shoqërisë.

Neni 4

Hyrja në Fuqi dhe Regjistrimi

4. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga Palët dhe i prodhon efektet në të njëjtën datë. Si rrjedhojë, nga data e nënshkrimit Kuota në bashkëpronësi konsiderohet e pjesëtuar dhe Palët zotërojnë kuotat respektive në Kapitalin e Regjistruar të Shoqërisë, sipas pjesëmarrjes të përcaktuar në Nenin 2 më sipër.
5. Palët pranojnë të zbatojnë dhe japin, me kërkesë të palës tjetër dhe/ose Shoqërisë, të gjithë dokumentacionin e duhur në përgjithësi, për të kryer çdo veprim të nevojshëm për të regjistruar pjesëtimin e Kuotës në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe përpara çdo autoriteti tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Të ndryshme

1. Kjo Marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë si dhe në kuadër të marrëdhënies mes Palëve, siç është përshkruar në Deklarimet Paraprake.
2. Janë anekse të kësaj Marrëveshje dhe pjesë përbërëse e saj, dokumentat si më poshtë:
- Vendim për Lëshimin e Dëshmisë së Trashëgimisë Ligjore, Notere Arjana E. Dodi, Nr.1373 Rep., Nr.320 Kol., datë 26.10.2020;
 - Dokumenta identifikimi të palëve;

Ky akt hartohet në 5 (pesë) kopje, me fuqi të barabartë ligjore dhe pasi iu lexua palëve me zë të lartë dhe u gjet në përputhje me vullnetin e lirë dhe të plotë të tyre u nënshkrua rregullisht dhe unë noterja duke e gjetur të bazuar në ligj e vërtetoi atë.

PALËT

Z.Sadik Ismailaj

Z.Jonuz Ismailaj



A2021050620235527926

Z. Idajet Ismailaj

Idajet Ismailaj

Znj. Rajmonda Agalliu (Ismailaj),

Rajmonda Agalliu

NOTERE

ARDJANA A. MEDIU

ARDJANA A. MEDIU

Idajet Ismailaj *Rajmonda Agalliu*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE VLORË

NOTER ARJANA E. DODI
ADRESA Lagje "Konferenca e Pezës"
Rruga "Jakov Xoxa" nr. 25
TEL: 696800430

VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 1373

Nr. koleksioni: 320

Fier më 26/10/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A2020062760030096175

DATE 26/10/2020
NR REP 1373
NR KOL 320

NOTER
TIRANË



LËSHIMI I DËSHMISË SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Sot, më datë 26 TETOR 2020, para meje Notere ARJANA E. DODI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore VLORË, me zyrë në adresën Fier, Lagje "Konferenca e Pezës" Rruga "Jakov Xoxa" nr. 25, u paraqit personalisht:

KËRKUESIT:

Sadik Ismailaj, atësia Mehmet, amësia Deko, shtetas Shqiptar, lindur në Siquece, Fier dhe banues në FIER, me adresë Muharrem Agalli 01490210; Nd. 26; H. 10; Fier; Fier; 9302; Fier, lindur më 03/02/1942, gjendja civile "i ve", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034523626 dhe nr. personal E20203169J.

OBJEKTI: Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerën QAZIME ISMAILAJ, atësia Rustem, amësia Shege, e datëlindjes 15/07/1941, lindur në Gjinoqar Fier, e martuar, me fëmijë, ish-banore e Njesisë Administrative Fier, nën juridiksionin e Bashkisë Fier, e cila ka ndërruar jetë më datën 21/08/2020.

BAZA LIGJORE: Nenet 316, 317, 318, 348, 360, 361 e vijues i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë", me ndryshimet, neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Pasi administrova në tërësi provat shkresore të prezantuara nga kërkuesi dhe dëgjova pretendimet e tij, Unë Noterja kryesisht, bazuar në nenin 111, 113 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, verifikova dhe konstatova se kjo çështje hyn në kompetencën e Shërbimit Noterial, të Degës Vendore Fier, përkatësisht Notere ARJANA E. DODI, me zyrë Noterie në Fier, Lagje "Konferenca e Pezës" Rruga "Jakov Xoxa" nr. 25, territor mbi të cilën shtrin kompetencën kjo zyrë për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Në këto kushte,

VËREJ:

Se kërkuesi Sadik Ismailaj, që është bashkëshorti i të ndjerës Qazime Ismailaj, ka paraqitur në këtë zyrë Noterie, një kërkesë për çeljen e trashëgimisë ligjore për Qazime Ismailaj, për të cilën ka interesa të ligjshme të lidhura me lëshimin e kësaj dëshmie trashëgimie, gjë që e legjitimon atë për kërkimin e paraqitur.

Gjithashtu zyra ime noteriale në Fier, në bazë të ligjit ka kompetencën tokësore për shqyrtimin e kërkesës, pasi vendbanimi i fundit i trashëgimlënës rezulton të ketë qenë në Fier, sipas certifikatës së vdekjes, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile 153 Fier, datë 08/10/2020.

Në lidhje me pretendimin e kërkuesit para meje noteres, u shtruan për zgjidhje këto çështje:

1. përcaktimi i trashëgimtarëve,
2. pjesët takuese të secilit prej tyre.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës, unë noterja bazohem në nenet 318, 318/1 dhe 318/2 të Kodit Civil, të ndryshuar, sipas të cilit "Trashëgimia çelet kur vdes trashëgimlënësi. Trashëgimia çelet në vendin ku ka pasur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi. Kur vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit nuk dihet, trashëgimia çelet në vendin ku ndodhet e gjithë pasuria e tij ose pjesa kryesore. Trashëgimia rregullohet sipas ligjit të kohës kur është çelur."

Nga analiza e dokumentave rezulton e provuar se:



Me certifikatën e vdekjes lëshuar më datë 08/10/2020 vërtetohet se më datën 21/08/2020 ka ndërruar jetë e ndjera Qazime Ismailaj, atësia Rustem, amësia Shege, e datëlindjes 15/07/1941, lindur në Gjinoqar Fier, me shtetësi shqiptare, me gjendje civile "e martuar", me fëmijë.

Meqënëse nga certifikata e vdekjes të të ndjerës Qazime Ismailaj, rezulton se ajo ka vdekur më datë 21/08/2020, në po këtë datë është bërë dhe çelja e trashëgimisë, prandaj ajo do të rregullohet me dispozitat përkatëse për trashëgiminë, të Ligjit nr.7850 datë 29.07.1994 "Kodi Civil i RSH", (i ndryshuar) i cili përfaqëson ligjin e kohës kur është çelur trashëgimia. Sipas nenit 361 të këtij ligji (Kodi Civil në fuqi), "Në radhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta".

Endjera Qazime Ismailaj, ka qenë martuar me **SADIK ISMAILAJ**, atësia Mehmet, amësia Deko, e datëlindjes 03/02/1942, lindur në Siquecë Fier dhe banues Fier, sipas certifikatës së martesës me numër akti 55 dt 19/05/1961, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Mallakastër me numër serie 015970198 dt 09/09/2020.

Sipas certifikatës së martesës të cilësuar më sipër, datëlindja e z. Sadik Ismailaj, figuron të jetë 03/02/1943, por nga shqyrtimi i gjithë akteve të gjendjes civile dhe kartës së identitetit, rezulton se Sadik Ismailaj i dtl 03/02/1943 është i njëjti person me Sadik Ismailaj, i dtl. 03/02/1942.

Nga martesa e Qazime Ismailaj me Sadik Ismailaj, **kanë lindur fëmijët:**

- 1-JONUZ ISMAILAJ, i datëlindjes 05/12/1961, gjinia mashkull,
- 2-IDAJET ISMAILAJ, i datëlindjes 22/01/1963, gjinia mashkull.
- 3-RAJMONDA AGALLIU, e datëlindjes 10/08/1966, gjinia femër,

Në certifikatat e vjetra të trungut familjar, Jonuz Ismailaj dhe Rajmonda Agalliu, figurojnë edhe "Jonus" dhe "Raimonda", por nga shqyrtimi i gjithë akteve të gjendjes civile dhe kartave të identitetit të këtyre personave, rezultojnë se "Jonuz Ismailaj" është i njëjti person me "Jonus Ismailaj" dhe "Rajmonda Agalliu (Ismailaj)" është i njëjti person me "Raimonda Agalliu (Ismailaj)".

Nuk rezulton që trashëgimlënësja Qazime Ismailaj, të ketë lënë trashëgimtarë të tjerë ligjorë përveç atyre të pasqyruar nga certifikatat e depozituara nga kërkuesi siç u treguan më lart, nuk ka fëmijë të tjerë të lindur nga martesa apo jashtë martese apo fëmijë të birësuar, si dhe nuk ka përjashtuar asnjërin prej tyre nga trashëgimia.

Gjithashtu nga verifikimi i rregjistrimit të testamenteve në Republikën e Shqipërisë, sipas Përgjigjes nr. 1334-5 datë 16/10/2020 lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Noterëve, nuk rezulton që e ndjera Qazime Ismailaj, të ketë lënë testament për disponimin e pasurisë së saj pas vdekjes. Nuk rezulton të ketë të dhëna për legun ose barrë mbi pasuritë e paluajtshme në emër të trashëgimlënësës. Nga sa më sipër, unë noterja konkludoj se kërkesa, është e drejtë dhe e bazuar në prova dhe në ligj, prandaj si e tillë duhet të pranohet plotësisht.

PËR KËTO ARËSYE:

Bazuar në nenet: 316, 317, 318, 320, 348, 360 e vijues të Kodit Civil, dhe neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "**Për noterinë**";

VENDOSA:

- Pranimin e kërkesës.
- Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësen **QAZIME ISMAILAJ, atësia Rustem, amësia Shege, lindur në Gjinoqar Fier më datë 15/07/1941 dhe vdekur në Turqi më datën 21/08/2020, me gjendje civile "e martuar", me shtetësi shqiptare**, me numër personal të identifikimit në Gjendjen Civile E15715106H, duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të saj të radhës së parë, bashkëshortin dhe fëmijët:

- 1- **SADIK ISMAILAJ**, atësia Mehmet, amësia Deko, i datëlindjes 03/02/1942, lindur në Siquece Fier dhe banues në Fier, me numër personal të identifikimit në Gjendjen Civile E20203169J,



bashkëshorti i trashëgimlënësës Qazime Ismailaj, i cili trashëgon 1/4 (një të katërtën) pjesë të pandarë të pasurisë trashëgimore të të ndjerës Qazime Ismailaj si dhe përgjigjet në të njëjtën masë për çdo detyrim të lënë prej saj.

2- **JONUZ ISMAILAJ**, atësia Sadik, amësia Qazime, i datëlindjes 05/12/1961, lindur në Siqece Fier dhe banues në Fier, me numër personal të identifikimit në Gjendjen Civile G11205068I, djali i trashëgimlënësës Qazime Ismailaj, i cili trashëgon 1/4 (një të katërtën) pjesë të pandarë të pasurisë trashëgimore të të ndjerës Qazime Ismailaj si dhe përgjigjet në të njëjtën masë për çdo detyrim të lënë prej saj.

3- **IDAJET ISMAILAJ**, atësia Sadik, amësia Qazime, i datëlindjes 22/01/1963, lindur në Siqece Fier dhe banues në Tiranë, me numër personal të identifikimit në Gjendjen Civile G301220100, djali i trashëgimlënësës Qazime Ismailaj, i cili trashëgon 1/4 (një të katërtën) pjesë të pandarë të pasurisë trashëgimore të të ndjerës Qazime Ismailaj si dhe përgjigjet në të njëjtën masë për çdo detyrim të lënë prej saj.

4- **RAJMONDA AGALLIU**, (mbiemri para martesë "Ismailaj") atësia Sadik, Amësia Qazime, e datëlindjes 10/08/1966, lindur në Patos Fier dhe banuese në Fier, me numër personal të identifikimit në Gjendjen Civile G65810093W, vajza e trashëgimlënësës Qazime Ismailaj, e cila trashëgon 1/4 (një të katërtën) pjesë të pandarë të pasurisë trashëgimore të të ndjerës Qazime Ismailaj si dhe përgjigjet në të njëjtën masë për çdo detyrim të lënë prej saj.

- Kërkuesi mori dijeni dhe iu sqarua nga Noterja detyrimi ligjor për depozitimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë ditë kalendarike), nga data e lëshimit të saj. Në rast të kundërt, për çdo ditë vonesë, aplikohen penalitetet përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi, referuar nenit 25, pika 2 e ligjit 111/2018 "Për Kadastrën".
- Dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrethit të trashëgimtarëve në çastin e regjistrimit pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, nuk mund të çënojë pjesën e bashkëshortit Sadik Ismailaj, të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës. Nëse trashëgimlënësja Qazime Ismailaj ka pasuri bashkëshortore të përfituara përgjatë martesës, por të regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, vetëm në emrin e saj, regjistrimi i pjesës takuese të trashëgimisë ligjore do të bëhet duke zbritur 1/2 pjesë të prezumuar të bashkëshortit pasjetues, në referim me nenin 76 të Kodit Civil, nenit 112, pika e ligjit 110/2018 "Për Noterinë". Gjithashtu nëse trashëgimlënësja është e prezumuar bashkëpronare në ndonjë nga pasuritë e regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, atëherë, pjesa e prezumuar e bashkëpronësisë së saj do të kalojë tek trashëgimtarët ligjorë sipas pjesëve takuese. Bashkëlidhur Tiranëcertifikata e martesës nr. akti nga Akti i martesës nr. 55, datë 19/05/1961 midis Sadik Ismailaj dhe Qazime Çukaj (Ismailaj), lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Arkiva e rrethit Mallakastër, seria 015970198 datë 09/09/2020, referuar nenit 112, pika 3 e ligjit 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".
- Shpenzimet Noteriale i ngarkohen kërkuesit.
- Kundër këtij vendimi për lëshim dëshmi trashëgimie ligjore, mund të bëhet ankim në Gjykatën kompetente, sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.
- Kjo dëshmi trashëgimie përbëhet nga 3 (tre) fletë dhe lëshohet në 6 (gjashtë) kopje origjinale nga të cilat, një depozitohet në arkivin e zyrës noteriale, një kopje i dorëzohet kërkuesit për ta paraqitur në institucionet përkatëse të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme dhe nga një kopje u vihet në dispozicion trashëgimtarëve ligjorë.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj dëshmie, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet në Fier, sot më datë 26 tetor 2020

NOTERE
ARJANA E. DODI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Fier

Njësia administrative Fier 153

Zyra e Gjendjes Civile 153

Datë: 08.10.2020

CERTIFIKATË VDEKJE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Përbërës të Gjendjes Civile	
Emri	Qazime
Mbiemri	ISMILAJ
Numri Personal	E15715106H
Emri i Babait	Rustem
Emri i Nënës	Shëge
Datëlindja	15-07-1941 (dyzet e një)
Vendlindja	Gjinoqar, Fier
Vendbanimi	MUHARREM AGALLI, Nd. 26; H. 10; FIER; 9302
Gjinia	Femer
Gjendja Civile	I/e martuar
Shtetësia	Shqiptare
Data e vdekjes	21-08-2020
Vendi i vdekjes	Spitali, Stamboll, Bagëllar, Turqi
Shkaku i vdekjes	

Kjo certifikatë lëshohet për _____

sig shoqërore

Nëpunësi i Gjendjes Civile

Anila Vruho

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)

